



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.58

Prishtinë, më 28.6.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të KDI –së D+ dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të datës 17.6.2016;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikës e Kosovës.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 17.6.2016;

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 17.6.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikës e Kosovës.

Anëtarët e Komisionit shqyrtuan nen për nen Projektligjin për Profesionet e Rregulluara në Republikës e Kosovës dhe propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Neni 1 riformulohet si vijon:

1. Qëllimi i këtij Ligji është përcaktimi i kushteve dhe kritereve për ushtrimin e profesionit të rregulluar që ka të bëjë me mbrojtjen e interesit publik.
2. Ky Ligj është në përputhje me Direktivën 2005/36/Ec e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 7 shtator 2005 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale (teksti me relevantë të EEA); dhe Direktivën 2013/55/eu e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 20 nëntorit 2013, që ndryshon direktivën 2005/36 / EC mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Rregulloren (BE) Nr.1024/2012 për bashkëpunim administrativ përmes Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm ("Rregullorja IMI") për njohjen e kualifikimeve profesionale si dhe në trajnimin specifik që kërkohet për disa profesione të rregulluara në sektorët e shëndetësisë dhe arkitekturës.

Amendamenti 2

Neni 2 paragrafi 2 riformulohet si vijon:

2. Ky ligj zbatohet për çdo person, i cili kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar në Republikën e Kosovës.

Neni 2 nën paragrafi 3.1. riformulohet:

- 3.1. Për veprimtaritë e ushtruara në profesionin e rregulluar, që lidhen me kryerjen e funksioneve në autoritetet gjyqësore

Amendamenti 3

Neni 3 riformulohet si vijon :

1. Shprehjet e përdorura në këtë Ligj kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Profesion i rregulluar** – veprimtari profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilit rregullohet me ligj apo me akte nënligjore që kërkon një licencë e cila kushtëzohet me një fushë dhe nivel të caktuar të aftësisë dhe edukimit profesional;
 - 1.2. **Kualifikim profesional** – kualifikimi i certifikuar i arritjes së njohurive dhe aftësive brenda një fushe studimi që rezulton me diplomë apo certifikatë.

- 1.3. **Dokument zyrtar** - nënkupton diplomën, certifikatën ose dëftesën, e lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, që dëshmon përfundimin e suksesshëm të kualifikimit profesional, të zhvilluar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës.
- 1.4. **ASHP-Agjencia Shtetërore e Provimeve të Kosovës** - agjenci e themeluar nga Qeveria, për organizimin e provimit shtetëror dhe publikimin e rezultateve për listën e profesioneve të rregulluara me këtë Ligj.
- 1.5. **KSHPRr - Këshilli Shtetëror për Profesione të Rregulluara** - organ vendimmarrës i themeluar nga Ministria i cili është përgjegjës për përcaktimin e standardeve për profesionet e rregulluara.
- 1.6. **Përvoja profesionale** - ushtrimi ligjor i një profesioni, për një periudhë të caktuar kohore.
- 1.7. **Praktika profesionale** - ushtrimi i një profesioni të rregulluar për një periudhë të caktuar kohore nga ana e praktikantit, nën udhëheqjen dhe përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar, i cili mund të shoqërohet me trajnime shtesë, sipas mënyrës së përcaktuar nga autoriteti kompetent.
- 1.8. **Provimi shtetëror** - vlerëson njohuritë dhe aftësitë e kandidatit për ushtrimin e profesionit të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi
- 1.9. **Kandidati** - personi i cili i nënshtrohet provimit shtetëror për ushtrimin e profesionit të rregulluar.
- 1.10. **Licenca** – dokument zyrtarë, i lëshuar nga organi kompetent, që i mundëson kandidatit ushtrimin e profesionit të rregulluar.
- 1.11. **Organi kompetent për zhvillimin e standardeve të profesionit** - (ministria e fushës përkatëse, agjencitë, odat profesionale, shoqatat, këshillat), organi përgjegjës për zhvillimin dhe përditësimin e standardeve të një profesioni të caktuar të rregulluar që ia paraqet ato për miratim Këshillit Shtetëror për Profesionet e Rregulluara.
- 1.12. **Autoriteti kompetent për licencim** - ministria e fushës përkatëse, apo, me delegim institucioni profesional, këshilli qeverisës i cili është përgjegjës për dhënie të licencave dhe provimit shtetëror të fushës përkatëse në bazë të kualifikimeve paraprake të përcaktuara me ligj.
- 1.13. **ENIC-NARIC Kosova** - Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik e Kosovës;
- 1.14. **Organi profesional** - institucion që organizon dhe përfaqëson profesionistët e një fushe të caktuar profesionale;
- 1.15. **Ministria** - Ministria përkatëse;
- 1.16. **Ministri** - Ministri përkatës;

Amendament 4

Neni 4 riformulohet si vijon:

Profesionet e rregulluara

1. Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës janë profesionet të:

- 1.1. Mjekut;
- 1.2. Stomatologut;
- 1.3. Farmacistit;
- 1.4. Infermierit;
- 1.5. Mamisë;
- 1.6. Fizioterapeutit;
- 1.7. Veterinerit;
- 1.8. Arkitektit;
- 1.9. Inxhinierit;
- 1.10. Mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit para universitar;
- 1.11. Edukatorit;
- 1.12. Psikologut;
- 1.13. Punëtorit social;
- 1.14. Pedagogut.

2. Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës, sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të plotësohen dhe ndryshohen me akt nënligjor të propozuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe të miratuar nga Qeveria.

3. Profesione të rregulluara janë edhe profesione të tjera të përcaktuara si të tilla me legjislacionin në fuqi.

Amendament 5

Neni 5 riformulohet si vijon :

1. Të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar e ka personi, i cili plotëson kriteret e përcaktuara me këtë ligj ose me ligje të tjera, të veçanta.
2. Profesionit i rregulluar ushtrohet nga personi fizik ose juridik, me cilësinë e të punësuarit ose të vetë punësuarit, sipas kërkesave të përcaktuara nga organi kompetent përkatës.
3. Ushtrimi i profesionit të rregulluar bëhet në përputhje me parimet e mëposhtme:
 - 3.1. liria e konkurrencës së profesionistëve;
 - 3.2. autonomia dhe pavarësia e gjykimit intelektual dhe profesional;
 - 3.3. korrektësia dhe cilësia e shërbimeve për mbrojtjen e përfituesit të shërbimit dhe të interesave publike, duke garantuar ushtrimin korrekt dhe ligjor të profesionit, pavarësisht mënyrës apo formës së ushtrimit të tij;
 - 3.4. liria e zgjedhjes nga përfituesi i shërbimit.

Amendamenti 6

Neni 6 riformulohet si vijon :

Neni 6

Aftësimi dhe kualifikimi për ushtrimin e profesionit të rregulluar

Personi, që kërkon të ushtrojë profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit apo kualifikimet profesionale për atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Amendamenti 7

Neni 7 riformulohet si vijon :

Neni 7

Kriteret për ushtrimin e profesionit të rregulluar

1. Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar, çdo person duhet të:
 - 1.1. Përfundojë studimet përkatëse apo kualifikimet profesionale;
 - 1.2. Përfundojë praktikën profesionale;
 - 1.3. Kryej provimin shtetëror;
 - 1.4. Regjistrohet në organin përkatës profesional.
2. Kriteret e parapara në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MASHT.

Amendamenti 8

Neni 8 riformulohet si vijon :

1. Këshilli Shtetëror për Profesione të Rregulluara (KSHPRr) është organ vendimmarrës i themeluar me këtë ligj nga Ministria.
2. KSHPRr përbëhet nga pesë (5) anëtarë.
3. Ministri emëron anëtarët e KSHPRr, me mandat katër (4) vjeçar.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e KSHPRr përcaktohen me akte nënligjore të nxjerrë nga MASHT.

Amendamenti 9

Neni 9 riformulohet si vijon :

Neni 9

Agjencia Shtetërore e Provimeve të Kosovës (ASHP)

1. Agjencia Shtetërore e Provimeve të Kosovës (ASHP) themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës me propozimin e Ministrisë përkatëse.
2. ASHP është përgjegjëse për:
 - 2.1. Organizimin e provimeve shtetërore për profesionet e rregulluara;
 - 2.2. Publikimin dhe certifikimin e rezultateve të provimeve shtetërore;
 - 2.3. Zhvillimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave të kandidatëve të cilët iu kanë nënshtruar provimit shtetëror.
3. Struktura, funksionimi dhe përgjegjësitë e ASHP-së rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MASHT.

Amendamenti 10

Neni 10 riformulohet si vijon:

1. Provimi shtetëror vlerëson njohuritë dhe aftësitë e kandidatit për ushtrimin e profesionit të rregulluar, me qëllim për të:
 - 1.1 Realizuar garancitë publike për përgjegjësitë që sjell ushtrimi i profesionit të rregulluar.
 - 1.2 Vlerësuar njohuritë e kandidatit që synon të ushtroj profesion të rregulluar, duke siguruar njëtrajtshmëri dhe transparencë në vlerësimin dhe kualifikimin e kandidatit, në nivel kombëtar, përmes verifikimit të përvetësimit të aftësive të nevojshme profesionale për profesionin e rregulluar.
2. Përmbajtja e provimit shtetëror hartohet në përputhje me fushën e veprimtarive profesionale.
3. Pas përfundimit me sukses të provimit shtetëror, kandidati merr licencën përkatëse profesionale, sipas listës së profesioneve të rregulluara.
4. Provimi shtetëror mbahet në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve.
5. Përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin shtetëror:
 - 5.1. Profesionistët, të cilët ushtrojnë apo kanë ushtruar një profesion të rregulluar në Kosovë para hyrjes në fuqi të këtij Ligji;
 - 5.2. Profesionistët, të cilët kanë fituar të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar jashtë Republikës së Kosovës, që përcaktohet në akte të veçanta nënligjore.

Amendamenti 11

Neni 11 riformulohet si vijon:

1. Provimi shtetëror për profesione të rregulluara, organizohet dhe mbikëqyret nga ASHP në bashkëpunim me KSHPRr dhe organet tjera kompetente.
2. ASHP për çdo profesion të rregulluar formon Komisionin e Provimit Shtetëror i cili përbëhet nga katër (4) anëtarë si në vijim:
 - 2.1. Një (1) përfaqësues të caktuar nga Ministri, kryetar;
 - 2.2. Një (1) përfaqësues nga ASHP;

2.3. Një (1) përfaqësues, i cili është anëtar i organit profesional përkatës;

2.4. Një (1) përfaqësues nga personeli mësimdhënës universitar, nga programi i akredituar me së paku dhjetë (10) vite përvojë pune në institucionet e arsimit të lartë.

3. Anëtarët sipas nën paragrafit 2.3 dhe 3.4. të paragrafit 2 të këtij neni emërohen sipas mënyrës në vijim:

3.1. Organi profesional përkatës i propozon ASHP-së të paktën dy (2) kandidatë, njëri prej të cilëve duhet të zgjidhet.

3.2. Këshilli Shtetëror për Profesione të Rregulluara, i propozon ASHP-së të paktën dy (2) kandidatë, njëri prej të cilëve zgjidhet.

4. Në rast se përfaqësimi i organit profesional i mundur, ASHP përfaqësohet me një (1) në Komisionin e Provimit Shtetëror nuk është anëtar shtesë.

5. Kryetari i Komisionit të Provimit Shtetëror është përfaqësues siç përcaktohet në pikën 2.1 të paragrafit 2 të këtij neni.

6. Kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohen nga ASHP në bashkëpunim me organin profesional të fushës përkatëse.

7. Rregullat për funksionimin e Komisionit të Provimit Shtetëror, kompensimin e anëtarëve të saj, si dhe procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të provimit shtetëror, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

8. Temat, mënyrat e zhvillimit dhe menaxhimit përmes teknologjisë digjitale të provimit shtetëror, përcaktohen nga ASHP, pas këshillimeve me organin kompetent.

Amendamenti 12

Neni 12 riformulohet si vijon:

1. Praktika profesionale synon përvetësimin efektiv të njohurive teknike, praktike dhe etike të profesionit, me anë të mekanizmave të përcaktuar nga ASHP-ja, sipas propozimeve nga organi profesional përkatës.

2. Praktika profesionale zhvillohet nën drejtimin e një profesionisti, personi fizik apo juridik.

3. Organi profesional përkatës, përmes strukturave të veta, siguron që aftësimi praktik në një profesion të rregulluar kryhet nën drejtimin e një profesionisti me përvojë, me të pakën tre (3) vite të përvojës përkatëse dhe që ofron garanci të mjaftueshme për përgatitjen teorike dhe praktike të praktikantit.

4. Gjatë realizimit të praktikës profesionale, praktikantit i jepet një pagesë prej jo më pak se 50 % të rrogës bazë.

5. Kompensime apo shpërblime të ngjashme të vlerësimit jepen nga institucioni/organizata ku mbahet praktika profesionale.

6. Pas përfundimit të suksesshëm të praktikës profesionale, çdo personi i bëhet me dije se ka përmbushur detyrimin për praktikë profesionale, që dëshmon se në një periudhë të caktuar dhe në përputhje me kriteret specifike të profesionit të rregulluar, ka qenë i angazhuar në një veprimtari profesionale, brenda ose jashtë vendit, e cili i ka dhënë mundësi të përvetësojë praktikë të mjaftueshme profesionale në fushën e këtij profesioni.

7. ASHP, në bashkëpunim me organin profesional përkatës, përcakton si vlerësohet nëse përvoja profesionale e kandidatit është e mjaftueshme për ta përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale.

Amendamenti 13

Neni 14 paragrafi 1.3. riformulohet:

1.3. Ministria është përgjegjëse për lëshimin e licencës, përveç rasteve kur kjo përgjegjësi i delegohet ndonjë organi apo shoqate profesionale

Amendamenti 14

Neni 15 paragrafi 4 riformulohet :

4. Organizimi dhe funksionimi i organit profesional bëhet me akt nënligjor.

Amendamenti 15

Neni 19 riformulohet:

1.Ministria brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, do të nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.

2. Në rast të konfliktit mes dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera për provimin shtetëror dhe licencimin e profesionistëve të profesioneve të rregulluara, dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë.

Amendamentet e Komisionit u procedohen Komisioneve të përhershme për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani